



European Credit Transfer System Information Package

Sistemi Evropian për Transfer të
Kredive
Paketa Informative

Universiteti i Vizionit Evropian - UVE

Adresa: Rr. Wesley Clark p.n.

Pejë - 30000

Kosovë

tel. + 381 (0) 39 431 684

e-mail. euro.uni@gmail.com

REKTOR

Edmon Beqiri, Dr.sc.,

Adresa: Rr. Wesley Clark p.n.

Pejë - 30000, Kosovë

mob. + 381 (0) 39 431 684

e-mail. ebeqiri@gmail.com

KOORDINATOR PËR ECTS

Bashkim Nurboja, MSc.,

Adresa: Rr. Wesley Clark p.n.

Pejë - 30000, Kosovë

mob. + 381 (0) 39 431 684

e-mail. bakinurboja@gmail.com

KOORDINATOR PËR CILËSI

Eija Vieri- Gashi, Mr.sc. inxh.,

Adresa: Rr. Wesley Clark p.n.

Pejë - 30000, Kosovë

mob. + 381 (0) 39 431 684

e-mail. ejjavg@gmail.com

Paketa informative u përgatit nga :

1. Prof. Dr. Edmond Beqiri
2. MSc. Bashkim Nurboja
3. Ligj. Mr.sc. inxh., Eija Vieri- Gashi
4. Ass. Sokol Domniku
5. Ba. Mentor Veseli

Përmbajtja:

1. Hyrje	5
2. Informacione për Kosovën dhe Pejën.....	6
2.1 Dokumentet e nevojshme për qëndrim	8
2.2 Akomodimi	8
2.3 Shpenzimet e jetesës.....	8
2.4 Shëndetësia dhe Sigurimi	8
3. Institucioni	9
3.1 Informata të përgjithshme	11
3.2 Drejtimit	11
3.3 Programet.....	14
3.4 Infrastruktura shkollore	15
3.5 Organizimi Studentor.....	16
3.6 ECTS Kreditë	16
4. Studimet.....	18
4.1. Kalendari Akademik.....	18
4.2 Mënyra e organizimit të mësimi.....	20
4.3. Vlerësimet.....	20
4.4 Notimi i Studentëve	21
4.5 Obligimet e studentit	23
4.6. Provimet.....	23
4.6.1. Rregullat e Provimit.....	24

1. HYRJE

Kjo paketë informative ju ofron një vështrim të strukturës së moduleve të ofruara nga Universiteti i Vizionit Evropian. Paketa i përmbahet standardeve të ECTS. Në të mund të gjeni edhe informata të shkurta në lidhje me Kosovën, Pejën dhe Universitetin e Vizionit Evropian

ECTS paraqet shkurtesë për European Credit Transfer System – Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive dhe është zhvilluar nga Komisioni Evropian me qëllim të krijimit të procedurave për njohje akademike të pjesës së studimeve jashtë shtetit. ECTS kreditë mundësojnë matjen dhe krahasimin e rezultateve të mësimin, dhe transferimin e njohurive të arritura nga një institucion në tjetrin.

2. INFORMACION PËR KOSOVËN DHE PEJËN

KOSOVA

Kosova shtrihet në pjesën qendrore të Ballkanit Perëndimor, në një territor kompakt dhe gati në formë rrethore. Ka një sipërfaqe prej rreth 10.908 kilometra katrorë. Në Kosovë kryqëzohen rrugët veri-jug (Budapest, Beograd, Prishtinë, Shkup, Selanik) që lidhin rrugët ujore prej Danubit deri në Detin Egje dhe ajo transversale lindje-perëndim (Stamboll, Sofje, Prishtinë, Tiranë, Durrës), kjo transversale lidhë detin Adriatik me Detin e Zi. Kjo pozitë është tejet e favorshme dhe i mundëson Kosovës zhvillimin ekonomik më të favorshëm për t’i valorizuar resurset e veta. Tani është e vendosur nën administrim të Kombeve të Bashkuara, gjegjësisht nën Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) prej Qershorit 1999.

Kosova është e krijuar nëpër fushë malore të Fushës së Kosovës dhe nga grupe malesh malore që e rrethojnë: vargmalet Bjeshkët e Rugovës dhe të maleve të Sharrit, që lartësohen deri në 2 640 m. Qytetet e mëdha janë Prishtina (kryeqyteti), Prizreni, Mitrovica, Peja, Ferizaj, Gjakova, dhe Gjilani. Në Kosovë aktualisht jetojnë rreth 2 milionë kosovarë rezident (rreth 183 banorë në një kilometër katror). Afërsisht 90% e popullatës janë shqiptare dhe 10% minoritete, prej të cilëve rreth gjysma janë serbë. Dendësia e popullsisë dhe shtimi natyror janë më të lartat në Evropë. Popullsia është vitale dhe e re: 63% nën moshën 30 vjeçare dhe vetëm rreth 5% mbi moshën 65 vjet. Në dekadën e ardhshme, popullsia e Kosovës pritet të rritet sipas normës vjetore 1.6-1.8 %.



Në Kosovë mund të arrihet në mënyra të ndryshme: aeroplan, rrugë magjistrale (pikat kufitare – Merdare nga Serbia, Kullë nga Mali i Zi, Hani i Elezit nga Maqedonia, Bajram Curri nga Shqipëria).

Në Kosovë mund të arrihet në mënyra të ndryshme: aeroplan, rrugë magjistrale (pikat kufitare – Merdare nga Serbia, Kullë nga Mali i Zi, Hani i Elezit nga Maqedonia, Bajram Curri nga Shqipëria).

Nga 1 Janar 2002, valuta evropiane euro është valutë zyrtare në Kosovë.

PEJA

Peja është qytet në pjesën perëndimore të Kosovës me rreth 120.000 banorë. Njihet si qytet i lashtë që nga koha Ilire. Për shkak të luftërave të shumta në këtë rajon, që nga pushtimi Otoman nuk është mundur të ruhet e gjithë karakteristika Ilire, ku përveç tjerash pësoi edhe Kalaja e Pejës dhe ndërtimet karakteristike të kohërave të lashta. Në kohën Ilire, Peja ishte një qendër e madhe vendbanimi. Sipas kërkimeve arkeologjike ky qytet kishte edhe një kala, mbi gërmadhat e lashta të së cilës mjerisht është ngritur fabrika e baterive industriale (FBI).

Disa kisha të mbetura në shumë vende të Kosovës që nga koha Ilire u transformuan në kisha ortodokse si p.sh. Patrikana në Grykë të Rugovës. Objekte karakteristike janë edhe: Çarshi-Xhamia e ndërtuar rreth viteve 1600 - 1700 si dhe Kulla e Haxhi Zekës.

Haxhi Zeka ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Prizrenit në vitin 1878 dhe organizator i Lidhjes së Pejës në vitin 1899. Në kohën e tij Peja i takonte Mbretërisë së Malit të Zi.

Njëra ndër panoramat më të bukura të Pejës është pa dyshim Gryka e Rugovës, e cila fillon menjëherë në dalje të qytetit, në anën perëndimore të tij. Nga ana veriore shtrihet Fusha e Pejës, Kodra e vreshtave, Fusha e madhe dhe Mali Para Fushe, që duket madhështor. Nga ana lindore gjenden vargmalet e Bjeshkëve të Rugovës, të ndara nga Gryka e Rugovës, ku në të djathtë gjendet maja karakteristike, që tani është pagëzuar "Maja e Piramidës" për shkak të formës karakteristike që ka.



Pranë qytetit kalon edhe Drini i Bardhë, i cili përveç tjerash mbledhë edhe ujërat e Lumëbardhit të Pejës. Lumëbardhi kalon nëpërmes qytetit dhe ka burimin në Bjeshkët e Rugovës.

Në Pejë nga aeroporti mund të arrihet për 1 orë me Taksi apo edhe me Autobusë që ndalet në magjistralen Prishtinë-Pejë. Autobusi mund të përdoret si mjet transporti edhe prej qyteteve tjera dhe pikave kufitare për rreth Kosovës.

2.1 Dokumentet e nevojshme për qëndrim

Për të pasur leje qëndrimi në Kosovë, mjafton që të keni pasaportë të vlefshëm dhe ti njoftoni organet komunale për adresën e banimit. Me rastin e hyrjes në Kosovë ju do të vulosni pasaportën tuaj në kufi, dhe ajo vullë vlen si leje qëndrim 3 muaj në Kosovë. Nëse dëshironi të qëndroni më gjatë se tre muaj, duhet të shkoni në zyrën për regjistrimin e të huajve në Prishtinë dhe të aplikoni për leje qëndrim çdo tre muaj.

2.2 Akomodimi

Për momentin Universiteti i Vizionit Evropian nuk posedon konvikt studentor, mirëpo Unioni i Studentëve të Universitetit ju ndihmon studentëve të jashtëm të gjejnë objekte banimi. Qiraja mujore kushton prej 50€ deri 70€ dhe në të përfshihen edhe mobilet por jo edhe rryma elektrike dhe ngrohja.

2.3 Shpenzimet e jetesës

Për shpenzimet bazë studentit i nevojiten përafërsisht: qiraja 70€, ushqimi 120€ të tjerat 60€.

2.4 Shëndetësia dhe sigurimi

Banorët e Kosovës mund të kërkojnë ndihmë në ambulancat e qytetit dhe në spitalin e përgjithshëm (që gjendet në perëndim të qytetit) për një shumë simbolike prej 1€, derisa studentët që tregojnë indeksin në sportel janë të liruar nga taksat. Gjithashtu ka edhe shume klinika private ku vlejné çmimet tjera.

Telefona të rëndësishëm:

- Policia 92 (me mobil 112)
- Ndihma parë 94
- Zjarrëfikësat 93

3. INSTITUCIONI

Universiteti i Vizionit Evropian

Adresa: Rr. Wesley Clark p.n.

Pejë - 30000

Kosovë

tel. + 381 (0) 39 431 684

e-mail. euro.uni@gmail.com

Koordinator për ECTS

Bashkim Nurboja, MSc.,

Adresa: Rr. Wesley Clark p.n.

Pejë – 30000, Kosovë

tel. + 381 (0) 39 431 684

e-mail. bakinurboja@gmail.com

Lista e mësimdhënësve aktual

1. Prof. dr. Edmond Beqiri – REKTOR
2. Prof. dr. Arsim Bajrami
3. Prof. dr. Esat Dauti
4. Prof. ass. dr. Hajredin Kuçi
5. Dr. sc. Marc Bryant
6. Prof. ass. dr. Muhamet Sadiku
7. Prof. dr. Sabahudin Komoni
8. Prof. dr. Muhamet Bicaj
9. Prof. asoc. Ekrem Kryeziu
10. Prof. ass. dr. Sabri Tahiri
11. Prof. ass. dr. Fatos Ukaj
12. Prof. ass. dr. Dilaver Salihu
13. Prof. ass. dr. Xheladin Zymberaj
14. Prof. ass. dr. Xhavit Aliqkaj
15. Prof. dr. Nysret Taraku
16. Prof. dr. Resmije Kryeziu

17. Prof. ass. dr. Xhemajl Ademaj
 18. Prof. dr. Riza Brada
 19. Prof. dr. Hilmi Asimja
 20. Prof. dr. Haki Dushi
 21. Prof. dr. Shaban Shkololli
 22. Dr. sc. Bakir Kelmendi
 23. Dr. sc. Qazim Bajraj
 24. Prof. Mr. sc. Mustafë Maloku
 25. Ligj. Mr. sc. Bashkim Nurboja (Magjistratura e kryer në ANGLI)
 26. Ligj. Mr. sc. Sali Kelmendi
 27. Ligj. Mr. sc. Durim Hoxha (Doktorant në Universitetin e Barcelonës)
 28. Ligj. Mr. sc. Arianit Kurti (Doktorant në Universitetin VAXJO - Suedi)
 29. Ligj. Mr. sc. Armand Krasniqi (Doktorant)
 30. Ligj. Mr. sc. Theranda Beqiri (Doktorant)
 31. Ligj. Mr. sc. Ilir Kelmendi (Doktorant)
 32. Ligj. Mr. sc. Izet Musaj
 33. Ligj. Mr. sc. Zana Gjocaj (Magjistratura e kryer në Britaninë e madhe)
 34. Ligj. Mr. sc. ing. Rexhep Nushi
 35. Ligj. Mr. sc. Genc Beqiri
 36. Ligj. Mr.sc. inxh. Eija Vieri-Gashi (ligjërues nga Finlanda) – Doktorant
 37. Ligj. Ms. BA.H. Sarah Aimes (ligjërues nga Britania e madhe)
 38. Ligj. Mr. sc. Rachael Newton (ligjërues nga ShBA)
 39. Ligj. Mr. Brad Byrd (ligjërues nga ShBA)
 40. Ligj. Mr. sc. Arbër Hadri
 41. Ligj. Mr. sc. Agim Kurmehaj
 42. Ass. BSc. Sokol Domniku (Magjistrant)
 43. Ass. BSc. Teuta Shabanaj (fituese e Bursës për studime Master në Staffordshire University - Britani e madhe)
 44. Ass. BSc. Albana Gazija
 45. Ass. BSc. Lindsay Roberts
 46. Ass. BSc. Joanna Neal
- Instruktorët e angazhuar:
1. Adem Tolaj – Instruktorë i MATEMATIKËS
 2. Ramadan Berisha – Instruktorë i Gjuhës ANGLEZE
 3. Kastriot Gjocaj – Instruktorë i KONTABILITETIT

3.1 Informatat e përgjithshme

Universiteti i Vizionit Evropian (në tekstin e mëtejshëm UVE) është i themeluar me 20 Maj 2006. Iniciativa për hapjen e këtij Universiteti është bazuar në nevojën e ekzistimit të një Institucioni akademik në rrafshin e Dukagjinit si pjesë përbërëse e Kosovës. UVE është institucion akademik privat i Licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.

UVE ofron studime në disa drejtime shkencore si:

- Administrim në Biznes
- Menaxhment
- Banka, Financa dhe Kontabilitet
- Informatikë e aplikuar
- Juridik i përgjithshëm
- Marrëdhënie Ndërkombëtare me Diplomaci
- Teknologji Ushqimore – Bioteknologji
- Edukim
- Arte
- Shkenca kompjuterike

UVE ofron studime në të gjitha drejtimit e sipërpërmendura në programet:

- Deridiplomë ose BACHELOR
- Pasdiplomë ose MASTER

3.2 Drejtimit

ADMINISTRIM NË BIZNES

Ky drejtim fokusohet në aspektin më të gjerë të biznesit ku trajtohen çështjet e fushës së biznesit si: biznes plani, ndërmarrësin, kostot e ndërmarrjes, shpërndarja e profitit, disa segmente të menaxhmentit, kontabiliteti fillestar dhe financiar, elementet e ekonomisë *mikro* dhe *makro*. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje administrojnë një biznes të cilësdo veprimtari ekonomike duke filluar prej veprimtarive prodhuese, tregtare-shërbyese, etj.

MENAXHMENT

Ky drejtim fokusohet në aftësimin e kandidatëve në aspektin e menaxhimit, udhëheqjes, njohjen e strukturës organizative të ndërmarrjes, planifikimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e bizneseve të vogla, etikën e biznesit, komunikimi dhe negocimi në biznes, psikologjia industriale, etj. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje të menaxhojnë departamente dhe resurse të ndryshme në ndërmarrje të strukturave të vogla dhe të mesme e veçanërisht atyre më të mëdha.

BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET

Ky drejtim fokusohet në dy fusha kryesore, në atë të llogaritjes financiare dhe menaxhimit financiar. Pikat kyçe që do trajtohen në kuadër të këtyre dy fushave janë: mbajtja e ditarit dhe kontabilitetit në nivel ndërmarrjeje ose banke, analizimi financiar, auditimi, buxhetimi dhe kreditimi, financat e korporatave, etj. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do të përgatitën dhe do të aftësohen që të jenë në gjendje të menaxhojnë aspekte të ndryshme në banka: financat, shkathtësi të larta llogaritëse, si dhe aftësi të mendimit dhe analizimit financiar.

INFORMATIKË E APLIKUAR

Ky drejtim fokusohet në njohjen e kandidatëve në përdorimin dhe aplikimin e teknologjisë informative në sfera dhe veprimtari të ndryshme. Çështjet kryesore që do mësohen në këtë drejtim do të jenë: Teknologjia e Informacionit, Rrjetat kompjuterike, Baza e të dhënave, Softuerët aplikativë, Elektrikë dhe Elektroteknikë, E-Business, Programim, etj. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje të jenë programorë të mirë dhe njohës të teknologjisë informatike, aplikimin e saj në sfera të ndryshme si dhe projektues të projekteve të ndryshme ekonomike, shkencore nëpërmjet të kësaj teknologjie.

JURIDIK I PËRGJITHSHËM

Ky drejtim fokusohet në aftësimin kandidatëve në aspektin e përgjithshëm të drejtësisë, duke filluar nga njohja e së drejtës pronësore, ekonomike, familjare, normave shoqërore e veçanërisht atyre juridike, çështjet kushtetuese, sociologjike. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje të veprojnë në funksione të ndryshme legjislative si *p.sh.* lidhjen e kontratave të ndryshme, kryerjen e funksioneve juridike në një organizatë qoftë ekonomike, sociale, ligjvënëse, shtetërore, etj.

MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI

Ky drejtim fokusohet në aspektin e fitimit të njohurive në fushën ndërkombëtare duke filluar nga njohja e sistemeve politike ndërkombëtare, suazat kohore juridiko-politike, kontratat ndërkombëtare, funksionet e organizatave juridike ndërkombëtar (Unioni Evropian, OKB-ja), marrëdhëniet diplomatike dhe juridike ndërkombëtare. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje të jenë bartës të çështjeve të ndryshme që janë në interes qoftë të një subjekti apo edhe të një shteti. Njohuritë e fituara do ndihmojnë këta kandidatë që të japin kontributin e tyre në sferat juridike, politike dhe diplomatike.

EDUKIM

Ky drejtim fokusohet sferën pedagogjike duke filluar nga fitimi i zotësive për trajnimin e fëmijëve të nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm. Pikat kryesore që trajtohen në këtë drejtim janë: filozofia e mësimin, psikologjia e pedagogjisë, gjuha shqipe, matematikë. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje të jenë trajnues të suksesshëm të gjeneratave të reja, të jenë të gatshëm të aftësojnë fëmijët dhe ti përgatisin në mënyrë sa më profesionale për një të ardhme të ndritshme.

TEKNOLOGJI E USHQIMIT - BIOTEKNOLOGJI

Ky drejtim fokusohet në studimin e elementeve të proceseve fermentuese, teknologjinë e produkteve të ndryshme si teknologjia e rrushit, e verës, e birrës, e qumështit, etj. Me përfundimin e suksesshëm të këtij drejtimi kandidatët do përgatitën dhe do aftësohen që të jenë në gjendje të jenë bartës të pozitave të rëndësishme në ndërmarrjet prodhuese e veçanërisht atyre industriale ku do luajnë rolin kryesor në aspektin e kompozimit dhe kontrollit të produkteve të ndryshme që do realizohen brenda asaj ndërmarrjeje.

3.3 Programet

UVE ofron studime në dy shkallë ose programe shkencore:

- BACHELOR i shkencës (BSc.) – 3 vjet studime ose 180 ECTS
- MASTER i shkencës (MSc.) – 2 vjet studime ose 120 ECTS

Thirrjet shkencore të sipërpërmendura bazohen në parimin e reformës mësimore të Bolonjës e njohur si Deklarata e Bolonjës (1999). Tërë plan programi mësimor në UVE bazohet në principet e kësaj Deklarate.

Thirrja **BACHELOR**

Që të fitohet thirrja BACHELOR kandidatit i nevojitet ti vijojë dhe përfundojë 6 semestra ku në secilin semestër duhet të mbledhë nga 30 kredi. Këto kredi fitohen duke i dhënë provimet që janë obliguese dhe që zakonisht përbëjnë 60% të lëndëve mësimore dhe ato zgjedhore (që i zgjedh vetë studenti) që përbëjnë 40% të lëndëve të përgjithshme. Kjo korrespondon me atë se 18 ECTS kredi fitohen nga lëndët obliguese dhe 12 ECTS kredi nga lëndët zgjedhore.

Në fund të studimeve studenti duhet të mbroj temën e diplomës dhe të arrijë shumën e 180 ECTS kredive për ta fituar thirrjen BACHELOR.

Thirrja **MASTER**

Që të fitohet thirrja MASTER kandidati i nevojitet ti përfundojë 4 semestra dhe ti likujdojë të gjitha provimet e parapara duke përfshirë edhe mbrojtjen e punimeve seminarike, të kryejë obligimet administrative, si dhe me sukses të mbrojë temën e Magjistraturës, ku në total i nevojiten të grumbullojë 120 ECTS (ose 300 ECTS duke përfshirë kreditë nga niveli BSc.)

Përshkrimi i organizimit:

3 semestra nga 3-4 module + 1 punim i publikuar = 3x30 ECTS

Semestri i katërt – Punimi i MASTER = 30 ECTS

3.4 Infrastruktura

UVE posedon një infrastrukturë moderne dhe të përbërë prej pajisjeve më bashkëkohore të punës. Infrastruktura e UVE-së përbëhet nga rreth 2500m² duke përfshirë, sallat e mësimit, salla e leximit (biblioteka), salla e profesorëve, administrata, zyra për ECTS dhe cilësi, kabineti i informatikës (të instaluar internetin e shpejtë cilësor), bufenë-restorantin e studentëve, kompjuterët në shumë kënde të objektit, rrjetin pa tela (Wireless Network) dhe kopshtin për pushim-inspirim.

Janë duke u përgatitur dhe instaluar laboratorë bashkëkohorë: laborator i mikrobiologjisë dhe laborator i kimisë.

Njëkohësisht në pikëpamjen strategjike në periudhën më afatgjatë është paraparë të ndërtohen edhe objekte të tjera moderne të cilat do të kenë kapacitet për 3.000 deri në 4.000 studentë.

3.5 Organizimi Studentor

Unioni i Vizionit Studentor është një organ i rëndësishëm dhe kompetent në çështjet organizative dhe akademike të Universitetit. Kontributi i tij është të asistojë në shumë çështje që janë në interes të të gjithë studentëve të Universitetit. Kryesisht këto çështje janë të aspektit organizativ ku përfshihen organizimet e ndryshme studentore, pastaj në aspektin akademik, mbikëqyrja e interesave të studentëve, moslejimi i diskriminimit ndaj tyre, pastaj në aspektin e vendimmarrjes (tre anëtarë të kryesisë së studentëve janë anëtarë të Senatit të UVE-së), etj. Unioni studentor ka hierarkinë e vet organizative të përbërë prej Kryetarit, dy nënkryetarëve, kryetarëve të komisioneve, si dhe anëtarët e kryesisë.

Kryetar: Fisnik Daci

Nënkryetarë: Ariana Muhaxheri, Kreshnik Vokshi

tel. + 381 (0) 39 431 684

3.6 ECTS kreditë

ECTS kreditë janë vlera numerike (në mes vlerave 1 dhe 60) të cilat përcaktohen për secilën lëndë mësimore dhe të cilat studenti i arrin pas përfundimit të lëndës mësimore dhe provimit në atë lëndë mësimore. ECTS kreditë reflektojnë sasinë e angazhimit total të studentit për të përfunduar lëndën mësimore të caktuar. Këtu përfshihen: ligjëratat (leksionet), puna praktike, seminarët, puna individuale (në bibliotekë apo në shtëpi) dhe provimet apo aktivitetet e tjera vlerësuese. ECTS kreditë paraqesin **vlera relative**, të cilat përcaktohen nga komisionet përkatëse të institucionit të shkollimit të lartë.

ECTS kreditë mundësojnë njohjen e pjesës së studimeve me anë të transferit të kredive dhe akumulimin e kredive në kornizë të një niveli të studimeve, si dhe mundësojnë bartjen e kredive prej një niveli të studimeve në tjetrin.

ECTS kreditë paraqesin vlera elementare numerike, të cilat përcaktohen për secilën lëndë mësimore dhe të cilat studenti i arrinë pas përfundimit të lëndës mësimore dhe provimit në atë lëndë mësimore.

Në sistemin ECTS, 60 kredi prezantojnë angazhimin e studentit për një vit të studimeve. Normalisht ndarja bëhet në 30 kredi për semestër. Asnjë nga lëndët mësimore nuk përcaktohet për shkak të kërkesave të ECTS-së, por për lëndët mësimore sipas rregulloreve të institucioneve përcaktohen kreditë ECTS.

Për secilën lëndë mësimore duhen që të llogariten numri i caktuar i pikëve kredituese, të cilat paraqesin 1/60 e angazhimit total të studentit gjatë vitit shkollor. Kreditë nuk bazohen vetëm në orë të mësimit/javë, por ato reflektojnë të gjitha aktivitetet e studentit si: *ligjëratat (leksionet), puna praktike, seminarët, puna individuale (në bibliotekë apo në shtëpi) dhe provimet apo aktivitetet e tjera vlerësuese.*

Institucionet arsimore mundën që të bëjnë edhe ndarje të mëtejshme të kredive për lëndë të caktuara mësimore. P.sh. *puna praktike dhe pjesët opsionale* që i takojnë një lënde mësimore të studimit mundën që gjithashtu të kreditohen (ose edhe të kundërtën, të mos kreditohen). Në anën tjetër në dokumentin e pasqyrës së notave mund të përfshihen edhe kurset (lëndët mësimore) jo të kredituara.

Kreditë fitohen pasi që të kompletohet lënda mësimore dhe provimi me vlerësimet e obligueshme të kryhen me sukses.

Dy shembuj:

1. Studenti i cili zgjedh programin e studimit me gjithsej 120 kredi për vitin akademik, duhet që të punojë dy herë më shumë se studenti i zakonshëm dhe
2. Studenti i cili zgjedh programin e studimit me gjithsej 30 kredi për vitin akademik, duhet që të punojë dy herë më pak se studenti i zakonshëm dhe trajtohet si *studentë jo i rregullt* (part-time student)

4. STUDIMET

4.1 Kalendari akademik

SEMESTRI VJESHTOR (01.10 – 15.02)

Gjithmonë fillon me 01.10, nëse është e diel të hënën 02.10

Ligjëratat prej datës 01.10 – 15.01

Afati i provimeve:

Nëntorit

- 01. – 30.11: provimet (3.) në kurset e semestrit pranveror të mëparshëm

Janarit - Shkurtit

- 16.01 – 22.01: provimet e fundit (4.) në kurset e semestrit pranveror të mëparshëm
- 23.01 – 15.2: provimet (1.) në kurset e semestrit vjeshtor të tanishëm

Ditët e lira të Universitetit

- Dita e parë e Ramazanit
- Dita e parë e Fiter Bajramit
- Dita e parë e Kurban Bajramit
- Dita e Flamurit (28.11)
- Krishtlindje (25.12)
- Nata e Vitit të Ri (31.12)
- Dita e parë e Vitit të Ri (1.1)

SEMESTRI PRANVEROR (16.02 – 30.06)

Gjithmonë fillon me 16.02, nëse është e diel të hënën 17.02

Ligjëratat prej datës 16.02 – 31.05

Afati i provimeve:

Prillit

- 01. – 30.04: provimet (2.) në kurset e semestrit vjeshtorë të mëparshëm

Qershorit

- 01. – 07.06: provimet (3.) në kurset e semestrit vjeshtorë të mëparshëm
- 08.– 30.06: provimet (1.) në kurset e semestrit pranveror të tanishëm

Ditët e lira të Universitetit

- E Hëne e Pashkëve
- Dita e punëtorëve (01.05)
- Dita e çlirimit të Pejës (16.06)

PUSHIMI VEROR

Afati i provimeve shtatorit

- 09. – 15.09: provimet e fundit (4.) në kurset e semestrit vjeshtorë të mëparshëm
- 16. – 30.09: provimet (2.) në kurset e semestrit pranveror të mëparshëm

4.2 Mënyra e organizimit të mësimit

Mësimi organizohet në dy semestra në atë vjeshtor dhe pranveror (për më shumë shikoni Kalendarin Akademik).

Për studentët të rregullt

Ligjëratat dhe ushtrimet mbahen në kohëzgjatje prej 45 minutash. Pas secilës orë bëhet pauza prej 15 minutash (ose 90 min ligjëratat 30 min pauzë).

Procesi mësimor mbahet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve dhe ushtrimeve laboratorike. Përveç formave të ndryshme aktive të mësimit përdoret sistemi i kolokviumeve, testimi dhe i ushtrimeve të obligueshme në mënyrë që përherë të ekzaminohet përparimi i studentëve gjatë studimeve.

Për studentët pa shkëputje nga puna (korrespondencë)

Ligjëratat dhe ushtrimet organizohen në mbrëmje, vikendeve. Poashtu, studentët me korrespondencë mund që në bashkëpunim me Mësimdhënësin të lirohen nga ardhja në ligjëratat po që me kusht të përfundojnë ndonjë punim, seminar apo çfarëdo pune që i udhëzon Mësimdhënësi. Për këtë punim studenti vlerësohet deri në 20% të notës dhe 80% do të vlerësohet në provimin përfundimtar. Studentët duhet që së paku dy herë brenda semestrit të takohet me Mësimdhënësin që ti marr udhëzimet e mëtutjeshme.

4.3 Vlerësimet

Studenti përcjellët dhe vlerësohet gjatë tërë semestrit me anë të testeve të ndryshme, kolokviumeve, punimeve seminarike, punimeve projektuese etj. Në këtë mënyrë studenti gjatë vitit fiton 40%-50% të notës në lëndën e caktuar dhe vendimi merret me rastin e provimit, kur studenti fiton 50%-60% të pjesës tjetër të notës përfundimtare. Në këtë mënyrë studenti i cili nuk është aktiv gjatë vitit, edhe në qoftë se i mundësohet që të dalë në provim, ai mund të fitojë vetëm 50-60% të notës (më së shumti notën 6, ose eventualisht 7 në qoftë se pjesën e provimit e punon në tërësi saktësisht!).

Në Universitetin e Vizionit Evropian provimet jepen në tri forma:

1. Vetëm me shkrim
2. Me shkrim dhe me gojë
3. Praktikë
4. Vetëm me gojë (lëndët teorike)

Në provime studenti ka të drejtë që të parashtrohet vetëm në 2 afatet e para të provimit, pasi që e ka dëgjuar lëndën mësimore. Vetëm për arsye të fortë Dekani mund të lejojë që studenti të pyetet edhe herën tretë apo të katërt. Për afatin e tretë dhe të katërt studenti paguan një pjesë të shpenzimeve të provimit. Në provime lejohet që të bëhet vetëm një herë përsëritja e vitit. Në qoftë se studenti dështon edhe në vitin e përsëritur, ai duhet që t'i drejtohet Dekanit me një arsyetim të fortë për vazhdim të studimeve.

4.4 Notimi i studentëve

Domethënia dhe ekuivalenca e notave të Universitetit të Vizionit Evropian me sistemin ECTS është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nota	ECTS nota	Suksesi në %	Përkufizimi
10	A	90%-100%	SHKËLQYESHËM – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
9	B	80%-90%	SHUMË MIRË –mbi mesatare standarde, por me disa gabime
8	C	70%-80%	MIRË – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
7	D	60%-70%	KËNAQSHËM- mirë, por me mjaftë gabime
6	E	50%-60%	MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale
5	FX	40%-50%	DOBËT- kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë
5	F	00%-39%	DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kreditë.

Pas mbarimit të provimit në lëndën e caktuar mësimore, studenti i fiton ECTS kreditë e parapara për atë lëndë mësimore. ECTS kreditë nuk duhet përzier me ECTS notat, sepse notat tregojnë suksesin individual të studentit të caktuar, kurse ECTS kreditë tregojnë angazhimin e çfarëdo studenti për të mbaruar detyrimet në atë lëndë mësimore.

Në certifikatat zyrtare të notave që lëshon Universiteti, shtohet edhe një kolonë, e cila do të paraqet notën ekuivalente ECTS afër secilës notë nga sistemi ekzistues.

Rekomandimet e ECTS-së për sukses në provim

Sistemi i notimit ECTS, përveç tjerash parasheh edhe rastin ideal duke paraqitur në përqindje numrin e studentëve të cilët duhet të marrin notën e caktuar të shkallës ECTS të notimit. Sipas këtij sistemi suksesi maksimal në lëndën e caktuar mësimore arrihet në qoftë se nga numri i përgjithshëm i studentëve arrihet suksesi si në vijim:

- notën A e fitojnë 10% të studentëve,
- notën B e fitojnë 25% të studentëve,
- notën C e fitojnë 30% të studentëve,
- notën D e fitojnë 25% të studentëve dhe
- notën E e fitojnë 10% të studentëve.

Në këtë sistem nuk parashihet fare ndonjë përqindje e studentëve me nota jo kaluese (FX dhe F), meqenëse parashikohet që një numër i vogël i studentëve që nuk e mbarojnë provimin në afatin e parë të provimit, do ta mbarojnë atë në afatin e dytë ose të tretë (afati i katërt i provimit nuk parashihet fare!).

P.sh. në qoftë se gjatë vitit shkollor ose semestrit të caktuar, lëndën *Matematika* e kanë vijuar rregullisht 40 studentë të një departamenti dhe të gjithë i kanë kryer të gjitha obligimet e parapara gjatë mësimin, atëherë normalisht se rezultat i suksesshëm do të konsiderohet në qoftë se që në afatin e parë të provimit fitohen:

- 4 nota A (ose 4 nota dhjetë të sistemit të notimit në UVE),
- 10 nota B (ose 10 nota nëntë të sistemit të notimit në UVE),
- 12 nota C (ose 12 nota tetë të sistemit të notimit në UVE),
- 10 nota D (ose 10 nota shtatë të sistemit të notimit në UVE),
- 4 nota E (ose 4 nota gjashtë të sistemit të notimit në UVE).

4.5 Obligimet e studentit

Studentët e rregullt dhe me korrespondencë janë të obliguar t'i vijnë mësimit (ligjëratat, ushtrimet dhe ushtrimet laboratorike).

Mësimi në studimet themelore të rregullta zgjatë 30 javë në vitin shkollor, me numër të ligjëratave dhe ushtrimeve prej 16 orë deri në 20 orë në javë.

Studenti i rregullt është i obliguar që të regjistrojë të gjitha lëndët e obligueshme (60% të lëndëve mësimore) dhe disa lëndë zgjedhore (40% të lëndëve mësimore). Të gjitha lëndët mësimore i kanë pikët kredituese, kështu që studentit i zgjedhë ato duke i grumbulluar së paku 60 kredi për një vit shkollor ose 30 kredi për një semestër. Përveç lëndëve zgjedhore, ekziston edhe kategoria e lëndëve opcionale, të cilat mund të zëvendësojnë lëndët zgjedhore deri në 20%. Lëndë opcionale mund të jetë secila lëndë mësimore që ofrohet në Universitet, e cila përkon me lëndën e studimit. Studenti mund të paraqes provimet e këtylla në ndonjë institucion tjetër të Universitetit dhe rezultatet t'i sjellë në Fakultetin amë.

Studenti mund të paraqes vetëm provimet për të cilat i ka kryer të gjitha obligimet në lidhje me vijim të mësimit (ligjëratat, ushtrimet dhe ushtrimet laboratorike/kabinetike). Në fund të semestrit të caktuar, studentit duhet që nga mësimdhënësit të marr nënshkrimet në Indeks, për të vërtetuar vijimin e rregullt të mësimit.

Studentët e fitojnë të drejtën në vërtetimin e semestrit në qoftë se i kanë të gjitha nënshkrimet e mësimdhënësve, pasi që t'i kanë kryer ushtrimet e parapara dhe në qoftë se i kanë kryer obligimet e tjera të cilat i cakton Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit, si kusht për marrjen e nënshkrimeve.

4.6 Provimet

Studenti është i obliguar që të paraqes së paku 10 (dhjetë) ditë më parë provimin të cilit dëshiron që t'i parashtrahet. Orari i mbajtjes së provimeve gjithmonë përpilohet dhe publikohet së paku një muaj para fillimit të afatit të provimeve, kështu që

studenti ka kohë që të planifikojë se kur do t'i parashtrohet provimit.

Gjatë vitit akademik mbahen 5 afate të rregullta të provimeve. Për më shume lidhje me datat e provimit shikoni seksionin e Kalendarit Akademik.

Afatet e provimeve janë:

a) Modulet vjeshtore:

1. Janar – Shkurt (afati i parë)
2. Prill (afati i dytë)
3. Qershor (afati i tretë)
4. Shtator (afati i katërt)
5. Përsëritet viti për modul nga **Tetori**

b) Modulet pranverore:

1. Qershor (afati i parë)
2. Shtator (afati i dytë)
3. Nëntor (afati i tretë)
4. Janar – Shkurt (afati i katërt)
5. Përsëritet viti për modul nga **Shkurti**

Rregullat e provimeve dallojnë nëpër Universitete por në Universitetin e Vizionit Evropian ekzistojnë këto rregulla që duhet të respektohen nga të gjithë:

4.6.1. RREGULLAT E PROVIMIT - UDHËZIME PËR KANDIDATËT

Rregulla të përgjithshme

1. Data e provimit në Universitetin e Vizionit Evropian nuk ndryshohet përveç në rastet kur konstatohet se është e pamundur mbajtja për ndonjë arsye të "fuqisë madhore" (Vis Major). Në rastet kur mësimdhënësi fizikisht nuk mund të vijë në provim (udhëtim zyrtar, rast vdekje në familje etj), ai/ajo duhet të kontaktojë zyrën për cilësi, e cila do ta organizojë provimin.

- 1.1 Në momentin kur hyni në provimi, duhet të tregohet karta identifikuese studentore e Universitetit (me fotografi) apo indeksi.

- 1.2 Në momentin kur hyni në provim, ju do të bëheni subjekt i mbikëqyrësve të autorizuar dhe duhet t'ju bindeni udhëzimeve të tyre.
- 1.3 Në provim nuk lejohet të mbani telefona celularë apo mjete tjera komunikuese.
- 1.4 Kur hyni në provim, të gjitha gjërat e paautorizuara: fletët, çantat, telefonat celularë, kalkulatorët etj. duhet të vendosen në vendin të cilin mbikëqyrësi e cakton.
- 1.5 Në qoftë se me vete gabimisht sjellën gjëra të paautorizuara, duhet të lajmërohen menjëherë mbikëqyrësit për të zbuluar praninë e këtyre gjërave. Nuk lejohet as:
 - Përdorimi i materialëve të paautorizuara në kalkulatorë, organizues apo i telefonave celularë
 - Kopjimi apo të provuarit për të kopjuar nga tjetri
 - Për ti ndihmuar dikujt tjetër
 - Largimi nga provimi për të marrë testin apo materialin pa autorizim të mbikëqyrësi.
- 1.6 Në qoftë se lejohet në provim fjalori apo kalkulatori duhet të siguroheni që ato fillimisht të kontrollohen nga mbikëqyrësi. Në qoftë se nuk e bëni këtë atëherë ato mund t'ju merren nga mbikëqyrësi.
- 1.7 Nuk duhet të filloni me provimin para se mbikëqyrësi t'ju udhëzojë të bëni një gjë të tillë.
- 1.8 Duhet të shkruani në mënyrë të qartë në fletë përgjigjet tuaja. Mësimdhënësi ka të drejtë të ftojë studentin për t'ia interpretuar punimin e shkruar në mënyrë të paqartë. Në qoftë se jeni me aftësi të kufizuar dhe keni nevojë për ndonjë trajtim të posaçëm si p.sh. ndihmë specifike, duhet të informoni Zyrën e Universitetit sa më shpejtë që është e mundur në mënyrë që t'ju ofrohet ndihmë në formën më të mirë të mundshme.

- 1.9 Gjatë provimit në asnjë mënyrë nuk duhet të komunikoni me dikë tjetër përveç me mbikëqyrësit. Çdo tentim i tillë do të konsiderohet si shkelje e Rregullave të Universitetit dhe për këtë arsye do të ndërmerren masat ndëshkuese.
- 1.10 Në qoftë se keni nevojë për ndihmë të mbikëqyrësit duhet të ngritni dorën. Nuk guxoni të lëshoni sallën pa lejen e mbikëqyrësit.
- 1.11 Pirja e duhanit është e palejueshme në sallën e mbajtjes së provimit.
- 1.12 Sasi të vogla të lëngjeve apo gjërave ushqimore janë të lejueshme të merren në provim. Në qoftë se mbikëqyrësi mendon se këto janë në sasi të tepërta do t'ju merren para apo gjatë provimit.
- 1.13 Në qoftë se mbikëqyrësi mendon se qëllimisht shkaktoni zhurmë dhe vazhdoni ta bëni atë edhe pas vërejtjes gjatë provimit, do t'ju kërkohet që të lironi sallën dhe të mos ktheheni prapa në provim.
- 1.14 Menjëherë duhet të ndaloni së shkruari, kur mbikëqyrësi ju udhëzon një gjë të tillë pas përfundimit të provimit. Kryembikëqyrësi cakton kohëzgjatjen e provimit.
- 1.15 Në përfundim të provimit duhet të qëndroni ulur dhe të heshtur derisa të mbledhën të gjitha provimet dhe mbikëqyrësi të udhëzojë lirim të sallës.

2. Pjesëmarrja në provime

- 2.1 Ju jeni përgjegjës që të mbani në mend datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimeve si dhe të paraqiteni me kohë para fillimit të provimit.
- 2.2 Nuk ju lejohet të hyni në sallë para se mbikëqyrësi t'ju udhëzojë për një gjë të tillë. Nuk duhet të hyni në sallë deri 10 minuta para fillimit të provimit apo kohës së caktuar.

- 2.3 Në momentin kur hyni në provim duhet të qëndroni aty së paku 30 minuta, por jo më tepër në qoftë se nuk dëshironi. Nuk do t'ju ofrohet kohë shtesë kandidatëve të cilët arrijnë pasi që fillon provimi.
- 2.4 Në qoftë se kërkohet nga mbikëqyrësi, duhet të tregoni dokumentin identifikues dhe plotësoni listën evidentuese.
- 2.5 Nuk mund të lëshoni vendin ku jeni të ulur për të mbajtur provimin pa lejen e mbikëqyrësit.
- 2.6 Në qoftë se përkohësisht kërkoni të lëshoni sallën e provimit duhet të kërkoni leje nga mbikëqyrësi i cili do t'ju përcjellë gjatë mungesës suaj.
- 2.7 Në qoftë se pa leje lëshoni sallën, provimi do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të keni mundësi që të ktheheni prapa në provim.
- 2.8 Në qoftë se dëshironi të lëshoni sallën para përfundimit të provimit, duhet të merrni leje nga mbikëqyrësi i cili fillimisht do të merr provimin tuaj. Është përgjegjësi e juaja të siguroheni që mbikëqyrësi ka marrë provimin tuaj. Nuk guxon të pengoni kandidatët tjerë në sallë gjatë largimit tuaj, duhet të respektoni rregullat e provimit derisa të dilni nga salla.
- 2.9 Kandidatët të cilët kanë dorëzuar provimin, nuk janë të lejuar të rikthehen në sallë.

3. Shkelja e Rregullave të Provimit

Për kandidatët për të cilët mbikëqyrësi beson se nuk kanë respektuar rregullat e provimit (ndihma e paautorizuar, kopjimi apo komunikimi me të tjerët) do të ndërmerren masa të bazuara disiplinore Akadematike të Universitetit.

1. Shkelja mund të konsiderohet nga Komisioni disiplinor apo nga dekani si:
 - 1.1. Shkelje e lehtë disiplinore
 - 1.2. Shkelje e kodit etik
 - 1.3. Shkelje e rënd disiplinore

2. Masat edukative/ disiplinore:

2.1. Qortimi me gojë

2.2. Vërejtje me shkrim e përcjellur me obligim të pagesës së provimit në afatin e ardhshëm. Vërejtja me shkrim bëhet pjesë e dosjes së studentit.

2.3. Parapërcjellim nga studimet

2.4. Përcjellim nga studimet